

## DEKLARATE PER SHTYP

Në kuadër të projektit “Siguri energjitike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjitike”, grant i Inisiativave Lokale, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, pjesë e SMART Balkans- projekt Rajonal, informojmë se është ngritur **“Këshilli Qytetar i Energjisë”**.

I mbledhur online më datë 30 Gusht 2023, ky Këshill Qytetar i Energjisë (KQE), mbështet shtresat në nevojë e kontribuon në forcimin, përfshirjen, mobilizimin e aktorëve lokalë e shoqërisë civile e influencën qytetare për sjelljen e ndryshimit pozitiv në dobi të menaxhimit aktiv të varfërisë energjitike në Berat.

Financuar nga SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” (Nr.SB LI 03/2023), organizata ka nënshkruar Memorandumin e Bashkepunimit me qytetarë aktiv në pesë qytete të Shqipërisë: Berat, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Tiranë, për ngritjen e Komitetit Qytetar të Energjisë, me qëllimin për të përmbushur objektivin e:

- Dakortësimin të planit të masave strategjike përmes instrumentit të “Këshillit Qytetar të Energjisë Angazhimi i KQE (Këshilli Qytetar i Energjisë) për lobim të masave prioritare për zbutjen e “Varfërisë energjitike” në shtresat në nevojë.

### **Në përmbushje të këtij Objektivi, ky Këshill Qytetar ka këto obligime:**

1. Ndërmjetësimin e komunikimit dhe ofrimin e informacioneve me KQE, përmes deklaratës për shtyp nga koordinatori i Organizatës “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” Berat, përfshirë komunikimet nëpërmjet mediave sociale, si dhe përcjelljes së saj në Bashkinë Berat.
2. Prezantimin e gjetjeve dhe promovimin e masave prioritare për zbutjen e “Varfërisë Energjitike” përmes aktiviteteve të ndryshme në vijim si dhe formave të komunikimit mediatic e mediave sociale.
3. Njohjen e sugjerimeve për marrjen e masave prioritare për zbutjen e “Varfërisë së Energjisë”, nga ana e Bashkisë Berat- komunikim fizik/elektronik.
4. Konsolidimin e KQE përmes aktiviteteve ndërfaqësuese në vijim, në lagjet dhe shkollat e Beratit.

Ky instrument- KQE, me sugjerimet e tij e prezantimin e masave prioritare në Bashkinë Berat, parashikon reduktimin e kostove, lehtësimin e faturave të energjisë, rritjen e termoizolimit të banesave e si rrjedhojë reduktim të “Varfërisë energjitike” tek shtresat në nevojë. Organizata “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” si dhe Palët e dakortësuara në Memorandum, konfirmojnë se ndajnë të njëjtin vizion për arritjen e sigurisë energjitike përmes këtij “Instrumenti” të ri që zbut varfërinë energjitike përmes një procesi gjithërfshirës, të ndjeshëm, transparent e profesional.



## DEKLARATE PER SHTYP



*«Deklarata për Shtyp», është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).  
Përmbajtja «Deklarata për Shtyp», është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)*





# DEKLARATE PER SHTYP

